

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORATI ADMINISTRATIV

Nr. Llog./Bil. str. 28

Data/Datum 03. 03. 2017

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 89, të datës 31.01.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27, shkronja (c dhe ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2015 dhe 2016, në vitin fiskal 2017

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 89, të datës 31.01.2017 për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2015 dhe 2016, në vitin fiskal 2017 në shumë të përgjithshme prej 1,631,761.46€, nga fondi burimor 21 dhe 22.
2. Ridestinimi i të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga fondi burimor 21 për bartjen e mjeteve financiare është në shumë prej 1,245,998.40 dhe fondi burimor 22 është në shumë prej 385,763.06€, të shpërndara në kategoritë ekonomike nëpër kodet e programeve dhe projekteve sipas skemës dhe përshkrimit në vijim:

Fond Buri	Org Buxh	Kodi i Prog	Programi	Kat Eko	Përshkrimi i Kat.Eko.Proj.	Kodi i Proj	Shuma e Zotimeve (Obligimet) Mjetet e lira për bartje
21	612	16002	Zyra e -	130	Mallra e -		5,000.00€
			- Kryetarit të Komunës		- shërbime		
21	612	16002	Zyra e -	200	Subvencione e -		5,022.30€
			- Kryetarit të Komunës		- transfere		
21	612	16302	Administrata	130	Mallra e -		5,000.00€
					- shërbime		
21	612	17502	Buxhet e -	130	Mallra e -		5,000.00€
			- Financa		- shërbime		

21	612	17502	Buxhet e -	300	Bashkëfinancimi i -	40081	18,991.89€
			- Financa		- projekteve		
21	612	17502	Buxhet e -	300	Pagesa për -	40086	58,155.54€
			- Financa		- vendime gjyqësore		
21	612	18162	Inf. Publike	130	Mallra e -		22,435.41€
					- shërbime		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Mirëmbajtja e -	40087	31,632.15€
					- infrastrukturës rrugore		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Mbjellja e -	40103	80,000.00€
					- pemëve dekorative		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Vendosja e -	43038	75,042.60€
					- ndriçimit publik solar dhe mirëmbajtja e tyre		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Ndërtimi i -	43039	24,754.20€
					- rrugëve me zhavor		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Mirëmbajtja e -	43041	8,729.70€
					- Investimeve: infrastrukturës rrugore, puseta e tjera		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Ndërtimi i -	43042	60,000.00€
					- urave në fshatrat: Pomozotin dhe Bardh i Madh		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Rregullimi i -	43044	71,653.16€
					- varrezave të dëshmorëve në Fushë-Kosovë		
21	612	18162	Inf. Publike	300	Ndërtimi i -	43045	17,778.16€
					- parqeve, trotuareve e këndeve të lojërave		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40109	49,001.09€
					- Fushë-Kosovë		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40110	30,000.00€
					- fshatin Graboc i Poshtëm		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40112	20,000.00€
					- fshatin Bardh i Vogël		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40113	9,329.20€
					- fshatin Sllatinë e Madhe		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40114	40,350.00€
					- fshatin Vragoli		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40115	17,274.58€
					- fshatin Miradi e Epërme		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40116	30,702.65€
					- lagjen Nakarad		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40117	13,396.15€
					- fshatin Harilaç		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40118	16,971.50€
					- fshatin Henc		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40119	20,000.00€
					- fshatin Lismir		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40121	50,000.00€
					- fshatin Bardh i Madh		

21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40122	64,393.75€
					- fshatin Miradi e Poshtme		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi i -	43048	27,558.00€
					- rrugëve dhe trotuareve Nakarad-Obiliq		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi i -	43051	45,000.00€
					- rrugës Vragoli/Batusë		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	43052	20,000.00€
					- fshatin Kuzmin		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Planet ideore -	43053	57,778.00€
					- për projekte		
21	612	66015	Urbanizëm	300	Ndërtimi i -	43054	190,000.00€
					- kanalizimeve dhe ujësjellësit		
21	612	73011	Shëndetësia	130	Mallra e -		10,000.00€
					- shërbime		
21	612	73011	Shëndetësia	200	Subvencione e -		10,000.00€
					- transfere		
21	612	73011	Shëndetësia	300	Blerja e -	40124	14,674.00€
					- Pajisjeve për shëndetësi		
21	612	73011	Shëndetësia	300	Ndërtimi i -	40126	89,862.51€
					- Shtëpive për raste sociale		
21	612	73011	Shëndetësia	300	Renovimi i -	40127	12,625.36€
					- Shtëpive për raste sociale		
21	612	85002	Kulturë -	130	Mallra e -		2,934.90€
			- Rini dhe Sport		- shërbime		
21	612	85002	Kulturë -	200	Subvencione e -		5,000.00€
			- Rini dhe Sport		- transfere		
21	612	85002	Kulturë -	300	Ndërtimi i -	40132	145,547.55€
			- Rini dhe Sport		- Fushave të Sportit		
21	612	92010	Arsim	130	Mallra e -		5,000.00€
					- shërbime		
21	612	92010	Arsim	200	Subvencione e -		5,000.00€
					- transfere		
22	612	18162	Inf. Publike	300	Ndërtimi i -	40088	9,455.14€
					- rrethojave të varrezave në Fushë-Kosovë		
22	612	18162	Inf. Publike	300	Pastrimi i -	40090	5,370.96€
					- ambientit		
22	612	18162	Inf. Publike	300	Ndërtimi i -	40091	30,195.96€
					- parqeve, trotuareve e shëtitoreve		
22	612	18162	Inf. Publike	300	Rregullimi i -	40099	15,457.00€
					- ujit në fshatin Harilaç		
22	612	18162	Inf. Publike	300	Mbikalimi në -	40100	40,000.00€
					- fshatin Miradi e Poshtme		
22	612	47042	Bujqësia	300	Pyllëzimi i -	40105	10,000.00€
					- sipërfaqeve të zhveshura		

22	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi në -	40112	10,000.00€
					- fshatin Bardh i Vogël		
22	612	66015	Urbanizëm	300	Asfaltimi i -	40120	6,852.00€
					- rrugës Miradi e Poshtme/Miradi e Epërme		
22	612	85002	Kulturë -	300	Botimi i -	40133	7,613.95€
			- Rini dhe Sport		- Librave, Revistave, Fletushkave, e tjera		
22	612	92010	Arsim	300	Ndërtimi i -	40137	5,204.26€
					- Shkollës Filllore në fshatin Vragoli		

Totali i buxhetit të pa shpenzuar për bartje 21 dhe 22 nga viti 2015 dhe 2016, në vitin 2017 është në shumë prej: 1,631,761.46€.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr. Sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 191, të datës 28.12.2016, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në lidhje me kërkesën e Këshillit Organizativ për përkujtimin e veprës së Abedin Sogojeva-Komandant Dini Nr. 01-016-38143, të datës 13.12.2016, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7 dhe nenin 27, shkronja (g, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 6, paragrafi 2, të Rregullores për ndarjen e titujve, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

**Për shpalljen z. Abedin Abdurrahman Sogojeva - Komandant Dini, post mortem
“Nderi i qytetit”, i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2017**

1. Z. Abedin Abdurrahman Sogojeva - Komandant Dini, i lindur më 26 Shkurt 1958 në fshatin Graboc i Poshtëm, Komuna e Fushë-Kosovës, shpallet post mortem “Nderi i qytetit”, i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2017, për kontributin, trimërinë dhe heroizmin e tij për lirinë dhe çlirimin e atdheut.
2. Veprimtari dhe luftëtari Abedin Abdurrahman Sogojeva - Komandant Dini, arsimin fillor e kreu në fshatin Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Madh, arsimin e mesëm në Drenas, punoi në Mihjen Sipërfaqësore të Bardhit të Madh, ishte i burgosur për veprimtarinë e tij atdhetare, organizator dhe komandant i themelimit të njësiteve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Komunën e Fushë-Kosovës më datë 21.06.1998 në fshatrat: Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Madh, luftëtar i devotshëm në betejat e Llapushnikut, Bardhit të Madh, Hades dhe Junikut. Pas luftës ishte pjesëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës që nga transformimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës prej vitit 1999-2007.
3. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS, Këshillit Organizativ dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 20, të datës 10.02.2017, në lidhje me kërkesën Nr. 02-016-1666, të datës 25.01.2017, e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për
Kompaninë 'Princi Compani'**

1. Aprovohet propozimi Nr. 20, i datës 10.02.2017, për lejimin e ndërrimit të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore të Ngastres Kadastrale Nr. P-72514003-00779-5, arë e klasës së pestë në sipërfaqe të përgjithshme prej 20000m², posedues nga qirambajtja për 99 vjet në emër të Istref (Sejdi) Elshani, në Zonën Kadastrale Harilaç, evidentuar në certifikatën e pronës 14-095-39002 për realizimin e projektit 'Riciklim, ambalazhim dhe asgjësim i mbeturinave', nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar 'Princi Compani', investitor Avni (Sali) Barani.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së
PU, Drejtorisë së BZHR, Palës dhe Arkivës.**


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 68, të datës 01.02.2017, në lidhje me kërkesën Nr. 01-016-2261, të datës 31.01.2017 e parashtruar nga Organizata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, e paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës, e shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqës prej 60m² të Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë për Organizata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, dega në Fushë-Kosovë

1. Aprovohet propozimi Nr. 68, i datës 01.02.2017, për dhënien në shfrytëzim të një pjesë të caktuar të objektit në sipërfaqe prej 60m², kati përdhësë (Ish kafe Gallery), në Shtëpinë e Kulturës në Fushë-Kosovë, rruga 'Nënë Tereza', për Organizatën e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, dega në Fushë-Kosovë.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe vlenë së zbatuari deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (a), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.1, nenin 4, paragrafi 1, nenin 5, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017', mori:


V E N D I M

Për themelimin e 'Komitetit për Zhvillim Ekonomik'

1. Për themelimin e 'Komitetit për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Fushë-Kosovës', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Sazana Statovci - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.2 Sabri Rexhepi - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.3 Naser Graiçevci - përfaqësues i PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.4 Elmi Shabani - përfaqësues i pavarur në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.5 Enver Bajçinca - anëtar;
 - 1.6 Isa Tahiri - anëtar;
 - 1.7 Ferdane Asllani - përfaqësuese e komuniteteve, anëtare.
2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e ekonomisë për zhvillimin ekonomik lokal.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Zhvillim Ekonomik, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.2, nenin 4, paragrafi 2, nenin 6, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017, mori:

V E N D I M

Për themelimin e 'Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit'

1. Për themelimin e 'Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Sabit Bullatovci - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.2 Shaban Ademi - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.3 Aida Alimi - përfaqësuese e PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.4 Ali Ismaili - përfaqësues i PD-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.5 Shemsi Kelmendi - anëtar;
 - 1.6 Hysen Merovci - anëtar;
 - 1.7 Beqir Beqiri - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e planifikimit urban dhe rural, kadastrit e gjeodezisë, shërbimeve publike dhe mbrojtjes së mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.


**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, nenin 4, paragrafi 3, nenin 7, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

V E N D I M

Për themelimin e 'Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport'

1. Për themelimin e 'Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport', në përbërje prej shtatë anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Milaim Berjani - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.2 Vjollca Konjusha - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.3 Migjen Kolshi - përfaqësues i PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.4 Ylber Islami - përfaqësues i pavarur në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.5 Ukshin Uka - anëtar;
 - 1.6 Emin Emini - anëtar;
 - 1.7 Hysni Hasani - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e edukimit dhe arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.4, nenin 4, paragrafi 4, nenin 8, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

V E N D I M

Për themelimin e 'Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'

1. Për themelimin e 'Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Remzi Shala - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.2 Mirishahe Berisha - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.3 Fazile Sejdiu - përfaqësuese e PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.4 Hasan Krasniqi - përfaqësues i pavarur në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.5 Ali Prebreza - anëtar;
 - 1.6 Ibrahim Berisha - anëtar;
 - 1.7 Gëzim Hoti - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (d), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.5, nenin 4, paragrafi 5, nenin 9, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

V E N D I M

Për themelimin e 'Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim'

1. Për themelimin e 'Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Nazmi Kelmendi - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.2 Arjeta Jashari - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.3 Ridvan Krasniqi - përfaqësues i PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.4 Fitore Simnica - përfaqësuese e PD-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.5 Ibush Kelmendi - anëtar;
 - 1.6 Idriz Bajçinca - anëtar;
 - 1.7 Radoman Doderovic - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
 2. Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, si: tërmetet, zjarret, vërshimet dhe fatkeqësive industriale dhe teknologjike.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.
- Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Stamp: REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIJA E ADMINISTRATIVES - DIREKTORAT ZA ADMINISTRACIJU
Nr. llog./Bil. str. 38
Data/Datum 10.03.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 3, paragrafi 1, pika 1.6, nenin 4, paragrafi 6, nenin 10, të 'Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve tjera', Nr. 04, të datës 12.01.2017' mori:

V E N D I M

Për themelimin e 'Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra'

1. Për themelimin e 'Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Bastri Sllamniku - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.2 Bedri Krasniqi - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.3 Sabit Godeni - përfaqësues i PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.4 Trandolina Duli - përfaqësuese e LVV-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.5 Ahmet Mehmeti - anëtar;
 - 1.6 Mal Mala - anëtar;
 - 1.7 Vladimir Velickovic - përfaqësues i komuniteteve, anëtar.
2. Komiteti për Bujqësi dhe Ujëra është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, në fushën e agrokulturës, rregullimit të sistemeve të ujitjes dhe pendave në lumenjtë e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 114, të datës 28.12.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 11, të 'Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna' Nr. 01/2015, nenin 10, paragrafi 5, të 'Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës', Nr. 62, të datës 16.05.2013, mori:

V E N D I M

Për formimin e 'Komisionit për hartimin e Planit të Veprimit të Transparencës për vitin 2017'

1. Për formimin e 'Komisionit për hartimin e Planit të Veprimit të Transparencës' për vitin 2017, në përbërje prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Arjeta Jashari - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.2 Migjen Kolshi - përfaqësues i PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.3 Trandolina Duli - përfaqësuese e LVV-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.4 Fitore Simnica - përfaqësuese e PD-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.5 Qerim Gara - përfaqësues i PDAK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.6 Nuriye Fazliju - Drejtore e Drejtorisë së Administratës, anëtare;
 - 1.7 Ali Topalli - Zyrtar për Informim, anëtar;
 - 1.8 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë i Kuvendit dhe Komiteteve, anëtar;
 - 1.9 Bardhyl Kojçi - Shef i Planifikimit dhe Buxhetit, anëtar;
 - 1.10 Ejup Qyqalla - Shef i Shërbimeve Publike, anëtar;
 - 1.11 Maliq Thaçi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit, nga pika një (1) e vendimit, është hartimi i 'Planit të Veprimit të Transparencës për vitin 2017', në përputhje me dispozitat Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Llogar/Gr. str. 41
Date/Datum 15.03.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Fushë Kosovë

Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 15, të datës 08.02.2017, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e taksave komunale për lëshimin e lejeve të ndërtimit në vitin 2017

1. Aprovohet në parim dhe dërgohet për diskutimit publik 'Propozimi për caktimin e taksave administrative për vitin 2017, për lëshimin e lejeve ndërtimore, në shumë prej 2.40€ për një metër katror'.
2. Aprovohet në parim dhe dërgohet për diskutim publik 'Propozimi për caktimin e taksave rregullative për rritjen e densitetit për vitin 2017, për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 2.40€ për një metër katror'.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 27, të datës 15.02.2017, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit dhe ndryshimin e etazhitetit

1. Aprovohet në parim dhe dërgohet për diskutim publik 'Propozimi Nr. 27, i datës 15.02.2017 për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit dhe ndryshimin e etazhitetit nga B+P+1, në B+P+7'.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Nr.faq/No. str. 43
Data/Datum 15.03.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 21, të datës 10.02.2017, në lidhje me kërkesën Nr. 05-350-2221, të datës 31.01.2017, e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e procedurave për lejimin e realizimit të projektit 'Qendra e Biznesit' për Kompaninë 'Marigona Tower'

1. Aprovohet 'Propozimi Nr. 21, i datës 10.02.2017, për fillimin e procedurave për lejimin e realizimit të projektit 'Qendra e Biznesit', nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar 'Marigona Tower', investitor Valon Bilalli, në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-01073-2, tokë pyjore, e evidentuar në certifikatën e pronës 14-464-38725, arë e klasës së tretë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 641622m², në vendin e quajtur 'Krivovë', posedues nga qirambajtja për 99 vjet, personi juridik 'Marigona Tower', në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe'.
2. Realizimi i projektit 'Qendra e Biznesit', nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar 'Marigona Tower', investitor Valon Bilalli, ndikon në rritjen e zhvillimit ekonomik, gjenerimin e vendeve të punës dhe nuk pengon në projektet zhvillimore të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Kryerja e procedurave tjera për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore, në tokë ndërtimore, për Ngastrën kadastrale të evidentuar në pikën një (1) të vendimit bëhet në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së BZHR, Palës dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.03.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DOKUMENTI I AUTENTIKIMIT - VERIFIKATA E ADMINISTRATIVË

Nr. Dokumenti: 44
Data/Datum: 15.03.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 66, të datës 01.02.2017, e paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës, e shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa e Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', Njësinë e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Aprovohet 'Propozimi Nr. 66, i datës 01.02.2017, për dhënien në shfrytëzim të pjesës në sipërfaqe prej 20 ari tokë pjesë e Ngastrës Kadastrale Nr. P-72514049-00202-0 dhe pjesës në sipërfaqe prej 50 ari tokë pjesë e Ngastrës Kadastrale Nr. P-72514049-00205-0, pronë komunale, e evidentuar në certifikatën e pronës 25-6559, arë e klasës së parë, në vendin e quajtur 'Kod dubova' në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', Njësinë e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Sipërfaqja e dhënë në shfrytëzim mbetet në pronësi komunale dhe lejohet të përdoret për vendosjen e mekanizmit për punë dhe ndërtimin e Qendrës për funksionimin e Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', Njësinë që vepron në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës dhe Drejtorisë së Inspektoratit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe vlen së zbatuari deri në marrjen e një vendimi tjetër.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së INSPK, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 67, të datës 01.02.2017, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësor në Shtëpi Pritëse në fshatin Henc

1. Për ndërrimin e destinimit të përdorimit të objektit shëndetësor, në Shtëpi Pritëse për nevojat dhe shërbimet e banorëve të fshatit Henc.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe vlen së zbatuari deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 109, të datës 09.02.2017, paraqitur nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për refuzimin e kërkesës Nr. 14.016-2030 për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim me qira të pronës komunale në fshatin Bardh i Madh

1. Për refuzimin e kërkesës Nr. 14.016-2030, të datës 30.01.2017, për palën Blerim Bajçinca, lidhur me fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim me qira të pronës komunale, ngastrës kadastrale Nr. P-72514010-01265-0, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 25-6606, në vendin e quajtur 'Shume Reka', në Zonën Kadastrale Bardh i Madh, me destinim për ngritjen e fermës së deleve.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP, Palës dhe Arkivës.




**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 25, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Projekt-Rregullores për Institucionet Parashkollore

1. Aprovohet në parim dhe dërgohet për diskutimit publik 'Projekt-Rregullorja për Institucionet Parashkollore' në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARSIMIT dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 74, të datës 06.02.2017, e paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës, e shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa e Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e procedurës për shpronësim dhe caktimin e lokacionit për varreza në Fushë-Kosovë

1. Aprovohet 'Propozimi Nr. 74, i datës 06.02.2017, për fillimin e procedurave të shpronësimit në bashkërendim dhe bashkëpunim me Korporatën Energjetike të Kosovës dhe caktimin e lokacionit afër ish/deponisë së mbyllur në mënyrë profesionale, në sipërfaqe prej pesë deri në dhjetë hektarë për ngastrat kadastrale në vijim:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00183-0, e evidentuar në certifikatën e pronës 25-6568, arë e klasës së tretë, në sipërfaqe prej 19793m², në vendin e quajtur 'G.njive', në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00184-0, e evidentuar në certifikatën e pronës 25-6569, arë e klasës së tretë, në sipërfaqe prej 10233m², në vendin e quajtur 'G.njive', në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.3 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00185-0, e evidentuar në certifikatën e pronës 25-6571, arë e klasës së tretë, në sipërfaqe prej 14391m², në vendin e quajtur 'G.njive', në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.4 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00186-0, e evidentuar në certifikatën e pronës 25-6572, arë e klasës së tretë, në sipërfaqe prej 14938m², në vendin e quajtur 'G.njive' në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.
2. Për realizimin e procedurave të shpronësimit për Ngastrat Kadastrale, të cekura në pikën një (1) të vendimit, në bashkëpunim me Korporatën Energjetike të Kosovës, formohet Komisionin prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
 - 2.1 Sabri Rexhepi - përfaqësues i LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 2.2 Sabit Godeni - përfaqësues i PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 2.3 Ylber Islami - përfaqësues i pavarur në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 2.4 Halil Qerimi - Nënkryetar i Komunës për Komunitete, anëtar;
 - 2.5 Hasime Qyqalla - Përfaqësuese Juridike e Komunës, anëtare;

2.6 Enver Asllani - Zyrtar i Kadastrit;

2.7 Nexhat Tërnavë - Përfaqësues i Bashkësisë Islame, Dega në Fushë-Kosovë.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2017, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejin e vizitës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Republikën e Shqipërisë

1. Për lejin e vizitës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës në Republikën e Shqipërisë.
2. Sigurimi i mjeteve financiare për realizimin e vizitës dhe kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi
